

DEKLARATA E GRUPIT PUNUES TË DALË NGA NENI 29 MBI OPINIONIN LIDHUR ME MBUROJËN E PRIVATËSISË NË MES TË BE-së dhe SHBA-ve.

Bruksel, 13 Prill 2016

Pas publikimit të draft vendimit për përshtatshmërinë e Mburojës së Privatësisë në mes të BE-së - SHBA-ve dhe dokumenteve përkatës, Grupi Punues i dalë nga Neni 29 ka mbajtur vlerësimin e tij duke marrë parasysh kornizën ligjore të aplikueshme për mbrojtjen e të dhënave të BE-së siç është përcaktuar në Direktivën 95/46/EC, si dhe të drejtat themelore për jetën private dhe mbrojtjen e të dhënave, të pasqyruara në nenin 8 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Nenet 7 dhe 8 të Kartës së të drejtave Themelore të Bashkimit Europian.

Qëllimi i Grupit Punues të dalë nga Neni 29 (në tekstin e mëtejshëm GP) është për të siguruar që një nivel esencialisht i barasvlershëm me mbrojtjen, të mirëmbahet kur të dhënat personale përpunohen në përputhje me dispozitat e Mburojës së Privatësisë.

Në përgjithësi, GP i mirëpret **përmirësimet e rëndësishme** të sjella nga Mburoja e Privatësisë krahasuar me vendimin e Safe Harbour-it. Në veçanti, futja e definicioneve kyçe, mekanizmat e ngritur për të siguruar mbikëqyrjen e listës së Mburojës së Privatësisë dhe shqyrtimet e jashtme dhe të brendshme tashmë të detyrueshme të përputhshmërisë janë një hap pozitiv përpara.

Megjithatë, GP ka **shqetësime të mëdha** në të dy aspektet tregtare dhe të qasjes nga ana e autoriteteve publike të të dhënave të transferuara në kuadër të Mburojës së Privatësisë.

Si një vërejtje paraprake, GP shpreh keqardhje se Mburoja e Privatësisë përbëhet nga një grup i dokumenteve të ndryshme dhe se për këtë arsye, parimet dhe garancitë e ofruara nga Mburoja e Privatësisë janë të përcaktuara si në vendimin e dhënë ashtu edhe në anekset e tij duke e bërë informacionin si të vështirë për ta gjetur, në kohë, dhe në mospërputhje. Kjo kontribuon **në një mungesë të përgjithshme të qartësisë**.

Pastaj, GP rikujton se Mburoja e Privatësisë e miratuar në bazë të Direktivës 95/46/EC ka nevojë të jetë në përputhje me kuadrin ligjor për mbrojtjen e të dhënave të BE-së, si në fushëveprim dhe në terminologji.

Në lidhje me këtë, një rishikim i tekstit të Mburojës së Privatësisë do të duhet të bëhet **pas hyrjes në zbatim të Rregullorës së Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave** në vazhdimësinë e vitit 2018, në mënyrë që të sigurojë nivel më të lartë të mbrojtjes së të dhënave të ofruara nga Rregullorja që është e ndjekur në Mburojën e Privatësisë.

Lidhur me aspektet komerciale, GP para së gjithash konsideron se disa nga parimet kryesore për mbrojtjen e të dhënave siç përcaktohet në ligjin Europian nuk janë pasqyruar në draft vendimin e dhënë dhe në anekset, ose kanë qenë të zëvendësuar në mënyrë joadekuate nga nocionet alternative. Në veçanti, zbatimi i parimit të kufizimit me qëllim të përpunimit të të dhënave nuk është i qartë. Grupi Punues është gjithashtu i shqetësuar se në parim ruajtja e të dhënave nuk është përmendur shprehimisht dhe nuk mund të interpretohet në mënyrë të qartë nga formulimi i tanishëm në tekst. Për më tepër, nuk ka formulim të veçantë për mbrojtjen e cili duhet të lejohet kundër vendimeve të automatizuara individuale të bazuara vetëm në përpunimin automatik.

Për arsye se Mburoja e Privatësisë do të përdoret gjithashtu për transferimin e të dhënave jashtë SHBA-ve, GP insiston se transferet e mëtejme nga një entitet i Mburojës së Privatësisë ndaj marrësve të vendeve të treta duhet të sigurojë të njëjtin nivel të mbrojtjes në të gjitha aspektet e mburojës (përfshirë sigurinë kombëtare) dhe nuk duhet të shpie në uljen apo të anashkalojë parimet e mbrojtjes së të dhënave të BE-së.

Përveç, edhe pse GP vë në dukje resurset shtesë që të vihen në dispozicion të individëve për të ushtruar të drejtat e tyre, është i shqetësuar se mekanizmi i ri si dëmshpërblim në praktikë mund të provojë të jetë shumë i ndërlikuar, i vështirë për t'u përdorur për individët e BE-së, veçanërisht në një gjuhë tjetër, dhe për këtë arsye i paefektsëm. Sqarimet e mëtejme të procedurave të ndryshme të mbështetjes për këtë arsye janë të nevojshme; në veçanti, kur ato janë të gatshme, autoritetet kombëtare për mbrojtjen e të dhënave të BE-së mund të konsiderohen si një pikë fizike kontakti për individët e BE-së në procedurat e ndryshme, duke pasur opcionin për të vepruar në emër të tyre.

Në lidhje me qasjen nga autoritetet publike në të dhënat e transferuara nën Mburojën e Privatësisë, GP ndjen keqardhje që përfaqësitë e Zyrës së Drejtorit të Inteligjencës Kombëtare të SHBA-ve (ODNI) nuk ofrojnë detaje të mjaftueshme në mënyrë që të përjashtojë mbledhjen masive dhe pa dallim të të dhënave personale me origjinë nga BE-ja. GP rikujton pozicionin e saj afat-gjatë se mbikëqyrja masive dhe pa dallim e individëve nuk mund të konsiderohet si proporcionale dhe domosdoshmërisht e nevojshme në një shoqëri demokratike, siç kërkohet nën mbrojtjen e ofruar nga të drejtat themelore të aplikueshme. GP vëren se ka një tendencë për të mbledhur gjithnjë e më shumë të dhëna në një shkallë masive dhe pa dallim duke marrë parasysh luftën kundër terrorizmit. Duke pasur parasysh shqetësimet që kjo sjell për mbrojtjen e të drejtave themelore të privatësisë dhe të mbrojtjes së të dhënave, GP shikon për vendimet e ardhshme të Gjykatës së Drejtësisë të BE-së në rastet lidhur me mbledhjen masive dhe pa dallim të të dhënave.

Për më tepër, GP mirëpret themelimin e një Ombudspersoni si një mekanizëm i ri rregullues. Kjo mund të përbëjë një përmirësim të dukshëm të drejtave individuale të BE-së për sa i përket aktivitete të inteligjencës së SHBA-së. Megjithatë, GP është i shqetësuar se ky institucion i ri nuk është mjaft i pavarur dhe nuk është i veshur me kompetenca adekuate për të ushtruar në mënyrë efektive detyrën e tij dhe nuk garanton një zgjidhje të kënaqshme në rast të mosmarrëveshjes.

Si përfundim, Grupi Punues vëren përmirësimet e Mburojës së Privatësisë që ofron në krahasim me vendimin e shfuqizuar të Safe Harbour-it. Por, duke pasur parasysh shqetësimet e shprehura dhe sqarimet e kërkuara, **i kërkon Komisionit për të zgjidhur këto shqetësime dhe të sigurojë sqarimet e kërkuara me qëllim të përmirësimit të draft vendimit të përshtatshmërisë dhe për të siguruar që mbrojtja e ofruar nga Mburoja e Privatësisë është me të vërtetë në thelb e barasvlershme me atë të BE-së .**